

SI TË SHMANGIM TITUJT KARREM PËR KLIKIM?

Asnjëri prej nesh nuk dëshiron që të bjerë viktimë e titujve bombastikë ose mesazheve karrem në internet. Këtu do të paraqesim disa mënyra për të shmangur materialet karrem (clickbait) dhe

Çfarë janë materialet karrem?

Kemi të bëjmë me tituj karrem kur faqe interneti ose postime përdorin tituj ose imazhe tërheqëse dhe të ekzagjeruara për të tërhequr vëmendjen tonë dhe të na nxisin që të klikojmë. Kjo bëhet për të tërhequr sa më shumë njerëz që të vizitojnë faqe të caktuara dhe të shohin reklama.

Problemi është se shpesh përmbajtja reale nuk përputhet me atë që paraqitet në titull dhe madje mund të jetë material mashtrues. Titujt karrem bazohen tek paraqitja e materialeve si më emocionuese ose më tronditëse se ç'janë në të vërtetë që t'a klikojmë.



Si ta dallojmë një titull karrem?

01



Kujdes nga titujt e bujshëm dhe termat e ekzagjeruara.



Nëse ju duket shumë e bukur për të qenë e vërtetë, tepër emocionale ose tepër tronditëse, ka të ngjarë të jetë karrem.

Verifiko burimin:

02



Shiko kush e ka krijuar atë mesazh? A ka emër autori?



Verifiko besueshmërinë e personit, faqes së internetit ose platformës që ka publikuar materialin.

Shqyrto adresën

03



Shiko mirë adresën e faqes për karaktere të pazakonta ose gabime drejtshkrimore.



Faqet legjitime zakonisht kanë adresa të qarta dhe koncize. Ki kujdes që të bësh dallimin midis faqeve të internetit të sigurta dhe të pasigurta. Faqet e sigurta kanë "https" në adresë dhe të dërgojnë të dhëna të koduara, ndërsa faqet e pasigurta përmbajnë vetëm "http" në adresë.

Mos i beso vetëm fotove ikonë (thumbnails):

04



Imazhet mund të keqinterpretohen. Lexo gjithmonë tekstin shoqërues për të kuptuar kontekstin. Kjo vlen si për fotot ikonë në YouTube, mediat sociale, reklamat që premtajnë mrekulli dhe rezultate të pabesueshme, ose link për ndonjë faqe interneti.



Titujt karrem shpesh përdorin imazhe tërheqëse që të nxisin të klikosh.

Verifiko saktësinë e informacionit:

05



Përdor faqet e internetit për verifikimin e fakteve për t'u siguruar mbi saktësinë e informacionit.



Keqinformimi përhapet shpejt; na ndihmo që të luftojmë dezinformimin duke verifikuar informacionin.

Tregohu i kujdesshëm kur ke të bësh me mesazhe emocionale:

06



Titujt karrem shpesh përdorin mesazhe emocionale për të tërhequr vëmendjen.



Nëse një titull po të ngacmon emocionalisht, mundohu të qetësohesh dhe analizo në mënyrë kritike materialin që ke përpara.

Verifiko datën e publikimit:

07



Sigurohu që të kontrollosh datën e publikimit të materialit.



Informacione të vjetra ka të ngjarë të mos kenë më vlerë dhe disa tituj karrem përdorin lajme të vjetra ose përmbajtje virale të ricikluara.

Mendo para se të klikosh:

08



Ndalo dhe mendo përpara se të klikosh mbi një link.



Pyete veten nëse burimi i informacionit ka reputacion të mirë, nëse informacioni duket i vërtetë, dhe nëse është diçka që ke vërtet nevojë ose dëshirë që të dish më shumë.